STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 3 prill 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON PROGRAMIN PREJ 38.5 MILIONE DOLLARE TE SHERBIMEVE PER TE NDIHMUAR VIKTIMAT E SUPER STUHISE SENDI (SANDY)

Banorët në NYC dhe qarqet Naso (Nassau), Safolk (Suffolk), Oranzh (Orange), Putnëm (Putnam), Roklënd (Rockland), Sallivën (Sullivan), Ulstër (Ulster) dhe Uestçestër (Westchester) do të marrin ndihmë në një vend për burimet që kanë lidhje me Sendin (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot një program prej 38.5 milionë dollarë që Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të mbikqyrë në bashkëpunim më Bamirësitë Katolike që do të sigurojnë mbi 200 koordinatorë të shërbimeve për të ndihmuar individët dhe familjet e prekura nga super stuhia Sendi (Sandy) që të rimëkëmben dhe të përdorin burimet thelbësore. Programi për Administrimin e Rasteve të Katastrofave (Disaster Case Management Program) (DCMP) siguron fonde federale shtesë për shtetet, territoret e SHBA-së dhe fiset e njohura federalisht pas shpalljes së katastrofës nga Presidenti që përfshin ndihmë individuale.

DCMP siguron fonde për një partneritet ndërmjet një administratori të rastit të katastrofës dhe një të mbijetuari të katastrofës për të krijuar dhe zbatuar një Plan të Rimëkëmbjes nga Katastrofa. Ky partneritet i siguron të mbijetuarit një pikë të vetme kontakti për të përdorur një sferë të gjërë burimesh. Procesi përfshin një vlerësim të nevojave të verifikuara të të mbijetuarit të shkaktuara nga katastrofa që nuk janë përmbushur, krijimin e një plani të orientuar drejt qëllimeve që përvijon hapat e nevojshme për të arritur rimëkëmbjen, organizimin dhe bashkërendimin e informacionit mbi burimet e disponueshme që përmbushin nevojat e shkaktuara nga katastrofa dhe mbikqyrjen e përparimit drejt arritjes së qëllimeve të planit të rimëkëmbjes, dhe, kur është e nevojshme, këshillimin e të mbijetuarit.

“Ndërsa rimëkëmbja nga Sendi (Sandy) vazhdon, po hyjmë në një fazë të rëndësishme ku shërbimet e drejtpërdrejta personale do t’u sigurojnë të mbijetuarve ndihmën që u nevojitet për të kthyer jetën e tyre në rregull,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Programi për Administrimin e Rasteve të Katastrofës (Disaster Case Management Program) mbulon çdo sferë të ndihmës për rimëkëmbjen që nevojitet nga individët dhe familjet për të siguruar se atyre që janë goditur rëndë nga stuhia u trajtohen nevojat e tyre

në mënyrë efikase dhe me efektshmëri. Duke punuar me partnerë si Bamirësitë Katolike do t'u sjellim më shumë burime drejtpërdrejt njerëzve që kanë më shumë nevojë për ndihmë."

"Uragani Sendi (Sandy) ishte absolutisht shkatërrues, fizikisht dhe emocionalisht," tha Monsinjor Kevin Sallivan (Kevin Sullivan) Drejtor Ekzekutiv i Bamirësive Katolike. "Shteti, qyteti dhe qarqet përreth kanë bërë një punë të mahnitshme duke e bërë ndihmën të disponueshme për ata që u prekën nga stuhia, por disa herë ata që preken mund të jenë të mbingarkuar nga ajo që u duhet për t'u rimëkëmbur. Të paturit e një pike të vetme të kontaktit për të shpjeguar gjerësinë e shërbimeve dhe për të ndihmuar në lundrimin në sistem mund të jetë një ndihmë e jashtëzakonshme për individët dhe familjet që janë duke u përpjekur të rimëkëmben nga shkatërrimi i Sendit (Sandy). Rreth 200 administratorë të rasteve do të jenë një portë ndihme dhe shprese për ata që janë prekur ndërsa fillojnë të rindërtojnë shtëpitë dhe jetën e tyre."

Koordinatorët e DCMP-së, që do të vendosen në vendndodhje në 13 qarqet e goditura më rëndë, mund të jenë një ndihmë e madhe për njerëzit që po përballen me shkatërrimin e super stuhisë Sendi (Sandy), por që mund të mos njohin sferën e shërbimeve që po ofrohen tani nga pushteti vendor dhe qeveria shtetërore e federale.

Koordinatorët e shërbimeve janë këshillues dhe lehtësues për ata që janë prekur nga Sendi (Sandy). Ata fillimisht vlerësojnë nëse klientët kanë nevoja të papërmbushura që kanë lidhje me stuhinë. Nëse njerëzit kualifikohen, atyre do t'u caktohet një administrator i rastit të katastrofës që do të shërbejë si një pikë e vetme e kontaktit për të gjithë ndihmën qeveritare dhe që ka lidhje me sigurimin. Pastaj, mbështetur në ndërveprimet më klientin, koordinatorët e shërbimeve krijojnë plane të personalizuara të rimëkëmbjes nga katastrofa, duke përfshirë këshillimin për përdorimin e shërbimeve të nevojshme, bashkërendimin e përfitimeve dhe bërjen e referimeve për shërbime jashtë sferës së administrimit të rastit të katastrofës. Shërbimet ekzistuese që kanë lidhje me Sendin (Sandy) për individët dhe familjet shkojnë nga fonde të drejtpërdrejta federale dhe shtetërore dhe hua të Shoqatës së Bizneseve të Vogla tek këshillime për sigurimin dhe referime tek sfera e programeve jo për fitim dhe vullnetare që janë krijuar.

DCMP i super stuhisë Sendi (Sandy) është modeluar sipas një programi të ngjashëm të zhvilluar nga Bamirësitë Katolike në 34 qarqe anembanë Shtetit të Nju Jorkut (New York State) pas Uraganit Irenë (Irene) dhe stuhisë tropikale Li (Lee) më 2011. Për ndihmë të Sendit (Sandy), Bamirësitë Katolike ose do t'i sigurojnë koordinatorët e shërbimeve drejtpërdrejt ose do t'i marrin ata me kontrata prej agjencive të vendosura në vend jo për fitim që kanë treguar përvojë me këtë lloj pune, si Këshilli Metropolitan për Varfërinë e Hebrenjve (Metropolitan Council on Jewish Poverty), Shërbimet e Bariut të Mirë (Good Shepherd Services), Shërbimi Shoqëror Luteran (Lutheran Social Service) dhe Qendra për Pavarësi të Personave me Pa-aftësi (Center for Independence of the Disabled). Bamirësitë Katolike gjithashtu do të kontraktojë disa organiza, si Shoqata e Komunitetit të Madh të Çajnataun (Greater Chinatown Community Association) dhe El Centro del Immigrante, që mund t'i sigurojnë këto shërbime në gjuhë shtesë, në mëyrë që asnjë komunitet i Nju Jorkut (New York) të mos mbetet pas.

Kualifikimi është i hapur për këdo me një nevojë të papërmbushur që u shfaq ose u përkeqësua nga super stuhia Sendi (Sandy), edhe për ata që nuk kanë bërë kërkesë tek FEMA për ndihmë. Ata që janë prekur nga stuhia mund të telefonojnë në 1-855-258-0483 për të mësuar vendndodhjen dhe informacionin e kontaktit për siguruesin më të afërt të shërbimeve pranë tyre. Një listë e plotë gjithashtu mund të gjendet në internet në www.catholiccharitiesny.org.

Shteti pret që më shumë se 10,000 njerëz të shfrytëzojnë këtë shërbim. Tashmë më shumë se 250,000 banorë të Nju Jorkut (New York) kanë bërë kërkesë pranë FEMA-s për shërbime që kanë lidhje me katastrofën pas Sendit (Sandy). Sipas FEMA-s, në katastrofat e kaluara, rreth 5% e aplikuesve pranë FEMA-s shfrytëzojnë shërbimet e administrimit të rasteve të katastrofave.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418